UB Online

# HYNI NË UB ONLINE



**UB Online** është një platformë moderne, e thjeshtë në përdorim ku të gjithë klientët mund të hyjnë nga kompjuteri i tyre ose nga telefoni nëpërmjet aplikacionit mobile.

Tashmë me një platformë të përmirësuar në funksionalitete dhe paraqitje ju mund të shfrytëzoni më mirë kohën dhe informacionin duke kryer të gjitha transaksionet tuaja financiare nëpërmjet UB Online pa qenë e nevojshme të paraqiteni në degët e bankës.

**Me UB Online përditshmëria juaj bëhet më e lehtë:**

- Shihni balancën e llogarive dhe veprimet tuaja bankare 24/7
- Transaksione të shpejta
- Paguani faturat
- Ruani përfituesit dhe kryeni pagesa shpejt në çdo moment
- Teknologjia më e fundit me sigurinë më të lartë

**PËR TË PËRDORUR PLATFORMËN UB ONLINE:**

Ju duhet të jeni klienti i Union Bank Shqipëri.
Ju mund të regjistroheni duke vizituar një nga degët e Bankës

**Me UB Online ju mund të:**

- Manaxhoni llogaritë tuaja, keni pamje të detajeve të Llogarisë dhe balancat e tyre, kontrolloni transaksionet si dhe mund të gjeneroni Lëvizje Llogarie
- Hapni një Depozitë me Afat, keni pamje të detajuar të depozitave ashtu si dhe mund të ndryshoni udhëzimet në maturim të depozitës
- Keni pamje të Plan-Pagesës së Kredisë ashtu si dhe shikoni Transaksionet per pagesat e kredisë.
  *(rregullat dhe rolet janë të përcaktuara nga klienti në momentin e regjistrimit)

- Transferta dhe Pagesa
  - Transferoni para midis llogarive tuaja personale,brenda llogarive të Bankës Union ashtu si dhe transferta jashtë Banke në monedhë lokale dhe te huaj. Krijoni Transferta Periodike dhe përcaktoni ato që dëshironi si Model Pagese (për transfertat e parave aplikohen rregullat në fuqi të Bankës)
  - Paguani fatura në faturues të ndryshëm dhe detyrimet në disa institucione shtetërore.
  - Aplikoni për këmbime valutore për të cilat mund të keni rëne dakord për një kurs këmbimi preferencial me Departamentin e Thesarit

  *(rregullat dhe rolet janë të përcaktuara nga klienti ne momentin e regjistrimit)

- Shërbime të tjera
  - Përdorni llogaritës të ndryshëm si Llogaritës të Depozitës me Afat, apo llogaritës për Këstet e Kredisë.
  - Mund të kërkoni online një sërë shërbimesh që lidhen me hyrjen pas regjistrimit

## Si të hyni në UB Online?

Ju mund të hyni nëpërmjet browser duke klikuar në linkun UB Online që shfaqet në faqen web: www.unionbank.al. UB Online mund të shkarkohet në formë aplikacioni në Play Store (për telefonat smart me sistem operativ Android) dhe në App Store (për sistemin operativ iOS). Kërkimi në Play Store/App Store bëhet me "UB Online", ku duhet të zgjidhet UB Online me zhvillues (developer) Union Bank Albania.

Për të hyrë në UB Online ju duhet të aktivizoni Soft Token i cili është një aplikacion sigurie i integruar në aplikacionin UB Online (Celular/Tablet) dhe gjeneron një fjalëkalim një përdorimësh sa herë që ju hyni në aplikacion. Vendosni emrin e përdoruesit i cili do t'ju dërgohet me email pasi të keni bërë regjistrimin në degë, dhe menjëherë do të merrni me email kodin dhe fjalëkalimin e aktivizimit si edhe me me mesazh numratorin e aktivizimit dhe numrin serial.







Pasi aktivizohet Soft Token krijoni një kod gjashtëshifror i cili do tju shërbejë për t'u identifikuar në UB Online.
Për më shumë ndihmë shikoni videon ilustruese → https://bit.ly/3cRYDPt

**Faqja Kryesore** - Në faqen kryesore të UB online do të shihni disa nga produktet dhe shërbimet kryesore që ju keni në bankë

- Llogaritë tuaja dhe llogarinë e kartës së kreditit
- Depozitat
- Kreditë
- Shërbime të shpejta/Tranferta dhe Pagesa
- Ngarko Dosje
- Rolet aprovuese dhe inicuese të përcaktuara nga kompania.

**Shikoni videon e aktivizimit të Soft Token në UB online.**

SHIKO VIDEON






## Llogari Rrjedhëse dhe Kursimi

Llogari Rrjedhëse dhe Kursimi ju jep një pamje të përgjithshme të të gjitha llogarive tuaja. Përdoruesi mund të shohë detajet individuale për çdo llogari. Nëpërmjet këtij opsioni jepen detaje për çdo llogari rrjedhëse dhe ato të kursimit si:

- Emri i klientit dhe numri i llogarisë
- Të dhëna bazë, si kodi i klientit, tipi i llogarisë, dega etj.
- Të dhëna mbi balancën si balanca e vlefshme, shuma e bllokuar, fonde të pa mbërritura, limite të overdraft-it

**Si të hyni? → *Faqe Kryesore* > *Llogari rrjedhëse kursimi* > *Përmbledhje e Llogarisë*** *(kliko mbi numrin e llogarisë për të parë më shumë)*



**Detajet e Llogarisë prezantohen në kohë reale në UB Online.**

Për më shumë informacion ju mund të kontaktoni agjentin tuaj të bankës, kontaktoni në numrat e shërbimit të klientit
+355 4 238 91 11 ose dërgoni email në Ubonline@unionbank.al